



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 67 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë të Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr.03/L të Punës, nenit 4 paragrafi 6 dhe 7 si dhe nenit 5 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Komuna e Prishtinës shpallë këtë:

K O N K U R S
TË BRENDSHËM PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA TË
PUNËS

DREJTORIA E SHËNDETËSISË

1. Pozita: Drejtor i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare

Niveli i pagës/koeficienti: 12

Orari i punës: I plotë

Mbikëqyrja: Drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Drejtori i QKMF-së është përgjegjës për të siguruar ligjshmërinë dhe punën profesionale të QKMF-së, e cila duhet të organizohet dhe të udhëhiqet në pajtim me dispozitat e Statutit dhe kësaj Rregullore;
- Drejtori i QKMF-së, është përgjegjës për përkujdesjen efektive të Kujdesit Parësor Shëndetësor për të gjithë banorët e komunës së Prishtinës, dhe përgjigjet për detyrat në vijim;
- Në pajtim me politikën shëndetësore, Ligjin për Shëndetësi në Kosovë dhe Strategjinë e Kujdesit Parësor Shëndetësor, i propozon Drejtorisë së Shëndetësisë planin e punës dhe buxhetin e QKMF- së, për vitin vijues;
- Në mbikëqyrjen dhe autorizimin e drejtorit të DSH, zbaton buxhetin e QKMF-së;
- Është përgjegjës për zbatimin e planit të burimeve njerëzore;
- Është përgjegjës për udhëheqjen e përditshme të procesit të punëve në QKMF;
- Është kompetencë e Drejtorit mandatimi bazuar në performancën e punës të Kryeshëfit, motrës kryesore të QKMF -së dhe shefave të njësive;
- Është përgjegjës për zhvillimin e marrëdhënieve të mira me donatorët dhe OJQ-të;

- Është përgjegjës për zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe trajnimin e personelit të QKMF-së;
- Është përgjegjës për vendosjen e mekanizmave të sigurimit të cilësisë së punës në Institucionin e QKMF-së;
- Është përgjegjës për dhënien e kontributit për zhvillimin e sistemit të informimit shëndetësor të informatave dhe avancimit të punës ekipore;
- Drejtori i QKMF-ës, për kryerjen e punëve të tij, i përgjigjet drejtorit të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Kryetarit të Komunës;
- Drejtori ka për detyrë që gjatë punës të tërheqë vërejtjen Këshillit Drejtues të QKMF - së për vendimet që mund të marrë, siç janë:
- Aktet e propozuara, të cilat janë në kundërshtim me ligjet relevante respektivisht aktet e përgjithshme të QKMF-së;
- Akti i propozuar, i cili është në kundërshtim me programin e punës së QKMF-së;
- Akti i propozuar, i cili nuk i kontribuon qëllimit.

Kualifikimi dhe përvoja:

- Specialist i Mjekësisë Familjare;
- Licencë përkatëse të lëshuar nga organi kompetent;
- Pesë (5) vite përvojë pune në shëndetësi, tri (3) vite përvojë menaxheriale në shëndetësi; □ Njohja e punës me kompjuter e domosdoshme.

2. Pozita: Drejtor i Qendrës së Mjekësisë Urgjente

Niveli i pagës/koeficienti : 12

Orari i punës: I plotë

Mbikëqyrja: Drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Organizon dhe koordinon punën në nivelin më të lartë menaxhues në QMU;
- Menaxhon dhe udhëheqë punët e përditshme në QMU-së;
- Mbikëqyrë në mënyrë të drejtpërdrejt dhe indirekte punën e punëtorëve të QMU-së;
- Organizon dhe përcjellë përsosjen profesionale dhe edukimin e vazhdueshëm të mjekëve dhe infermierëve si dhe punëtorëve të tjerë sipas programit të planifikuar;
- Ndërmerr masa për përparimin e punës, modernizimit dhe përmirësimit të kushteve të punës në QMU;
- Organizon analizën dhe hulumtimin e metodologjisë së punës, teknologjinë në punë, strukturën e popullatës që është atakuar si dhe gjendjet urgjente;
- Propozon projekte të caktuara në lëmin e mjekësisë urgjente;
- Organizon mbledhjen e mëngjesit me personelin shëndetësor;

- Ndërmerr masa urgjente duke organizuar ekipe mjekësore për aksidente individuale dhe masovike (ndeshjet në komunikacion), fatkeqësitë elementare (tërmeti, vërshimet, djegiet, manifestimet e mëdha kulturo-sportive, sulmet terroriste etj.);
- Në rast nevojë formon edhe komisione të ndryshme;
- Kryen edhe punë të tjera sipas legjislacionit në fuqi dhe sipas kërkesës së drejtorit të DSHMS-së.

Kualifikimi dhe përvoja:

- Të jetë i specializuar në mjekësinë emergjente apo mjekësinë familjare;
- 3 vite përvojë pune në Sektorin e shëndetësisë;
- Plotëson edhe kushtet e përgjithshme të parapara me Ligj dhe Statut të QMU-së.

Data e shpalljes së Konkursit: 10.08.2021 deri më dt. 24.08.2021

Të drejtë konkurrimi kanë vetëm të punësuarit në Institucionin e Komunës së Prishtinës të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit për avancim.

Komuna e Prishtinës ofron mundësi të barabarta për të gjithë nëpunësit ekzistues brenda komunës. Rekrutimi dhe përzgjedhja do të bëhet në përputhje me Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik.

Afati i konkurrimit do të jetë **15 ditë** nga dita e publikimit në web faqen zyrtare të Komunës së Prishtinës.

Aplikacionet do të merren dhe dorëzohen në Qendrën për shërbim me qytetarë të Komunës së Prishtinës.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten: Kopja e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, përvojës së punës, kopjet e dy raporteve të fundit të njëpasnjëshme të vlerësimit të punës si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme të kërkuara sipas kushteve të konkursit.

VËREJTJE: Fletë aplikacionet e kandidatëve me dokumente të pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit, nuk do të merren në shqyrtim, dhe dokumentacioni nuk do të kthehet.

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë të nostrifikuara diplomat nga MASHT-ë.

Për informata të hollësishme mund të kontaktoni me Zyrën e Burimeve Njerëzore në nr. tel: 038/230-900, lok. 1070, apo Drejtorinë e Shëndetësisë me nr.tel.230-900, lok.11-87, prej orës 08:00 – 16:00 me adresë Komuna e Prishtinës, Rruga UÇK nr. 2, Prishtinë – Republika e Kosovës.